



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, 22 dhjetor 2023
Nr. ref.:RK 2311/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI189/22

Parashtrues

Muhamet Krasniqi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [nr.09/2049] të Këshillit Gjyqësor të Kosovës - Komisionit për Kompensimin e Dëmit të personave të dënuar pa arsye dhe personave të hequr pabazë nga liria, të 7 nëntorit 2022

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Muhamet Krasniqi, me vendbanim në fshatin Leshan, Komuna e Pejës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Besart Alimusaj, nga fshati Strelc i Epërm, Komuna e Deçanit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [Nr.09/2049] të 7 nëntorit 2022 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës - Komisionit për Kompensimin e Dëmit (në tekstin e mëtejme: Komisioni për Kompensimin e Dëmit i KGJK-së).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Komisionit për Kompensimin e Dëmit, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 1[Shteti], 3 [Barazia para Ligjit], 7 [Vlerat], 16 [Epërsia e Kushtetutës], 17 [Marrëveshjet Ndërkombëtare] 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22, 23, 24 [Barazia para Ligjit], 25 [E Drejta për Jetën], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 36 [E Drejta e Privatësisë], 46 [Mbrojtja e Pronës], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], dhe 112 [Parimet e Përgjithshme], 128, 132, 141, 155 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta); nenet 2 (E Drejta për jetën), 3 (Ndalimi i torturës), 7 (Nuk ka dënim pa ligj), 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare), 14 (Ndalimi i diskriminimit), 17 (Ndalimi shpërdorimit të të drejtave), dhe 41 (Shpërblimi i drejtë); të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), dhe nenet 6, 8, 10 dhe 11 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], dhe paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa Individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Me 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform Rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 2 dhjetor 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 5 dhjetor 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [Nr.GJR.KI189/22] dhe Vendimit [Nr.KSH.189/22] caktoi gjyqtaren Selvete Gërzhaliu-Krasniqi Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Remzie Istrefi-Peci.
8. Më 9 dhjetor 2022, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga i njëjti që të dorëzojë formularin e kërkesës.

9. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
10. Më 10 janar 2023, për herë të dytë, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga i njëjti që të dorëzojë formularin e kërkesës.
11. Më 26 janar 2023, parashtruesi i kërkesës dorëzoi formularin e kërkesës në Gjykatë.
12. Më 23 maj 2023, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
13. Më 14 nëntor 2023, Gjykata shqyrtoi raportin paraprak të propozuar nga Gjyqtari raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

14. Nga shkresat e rastit rezulton se më 11 nëntor 2016, Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Krimeve të Rënda (në tekstin e mëtejme: Prokuroria Themelore) ngriti aktakuzën PP/1.nr.64/2016 kundër parashtruesit të kërkesës për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i informatës zyrtare nga paragrafi 1 i nenit 423 i Kodit Nr.04/L-082 Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK).
15. Më 10 korrik 2017, Gjykata Themelore në Pejë, përmes Aktvendimit [PKR.nr.163/16], hodhi poshtë aktakuzën e Prokurorisë Themelore, dhe pushoi procedurën penale ndaj parashtruesit të kërkesës. Po ashtu kishte hedhë poshtë aktakuzën e Prokurorisë Themelore në pikat III dhe IV të dispozitivit të aktakuzës dhe kishte pushuar procedurën penale ndaj të akuzuarve A.Sh. dhe M.Sh.
16. Kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore, ankesë kishte paraqitur edhe Prokuroria Themelore në Gjykatën e Apelit, për shkak të shkeljes të drejtës procedurale, me propozimin që të prishet aktvendimi i Gjykatës Themelore dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.
17. Më 18 gusht 2017, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PN.nr.602/17] ndryshoi një pjesë të aktvendimit sa i përket të akuzuarve tjerë, ndërsa pjesën e aktvendimit të Gjykatës Themelore që lidhet me parashtruesin e kërkesës e la në fuqi.
18. Më 5 tetor 2022, parashtruesi i kërkesës paraqiti Kërkesë drejtuar Komisionit për Kompensimin e Dëmit, për dëmshpërblim, *“për shkak të privimit pa bazë nga jeta normale në punë, pezullimin nga puna dhe procedurës penale të pa bazuar në prova materiale as faktike por vetëm me supozimin jo njerëzor dhe anti ligjor”*.
19. Në kërkesë, parashtruesi i kërkesës theksoi se nga viti 2013 deri në vitin 2018 ka qenë viktimë e aktakuzave të pabaza juridike, nga prokurorja S.G., dhe si pasojë, reputacioni i tij është dëmtuar, duke theksuar se kjo periudhë: *“Unë kame prova ,se isha objekt i hetimeve nga viti 2013 deri ne përfundim te kësaj padrejtësie ndaj meje, sepse isha objekt i procedurave penale, para dhe gjate procedure deri ne përfundim te procedurës isha i pa fajshëm . U shpalla i pa fajshëm ne një proces te drejtësisë se vonuar diku 5 vite, ne shkelje te drejtave te mia elementare për një jete, me te mira materiale për mua dhe familjen time ”*. Tutje, shtoi se kërkon: *“kompensimin material dhe jo material dhe te postohet ne media elektronike shpallet aktgjykimi se unë jam i pa fajshëm, sepse isha objekt i mashtrimit dhe njollosjes se emrit dhe nderit time dhe te familjes, sime. Dëmet jo material janë te pa riparueshme dhe si dëme material janë diku 100,000 euro. Kurse, për harxhime procedurale ,pagesat e avokatit diku 20,000euro apo sipas tarifave te oak, për shkaqe te humbjes se emrit time si toger i policisë kërkoj shumën 50.000, dhe*

për kohën e humbur kërkoj shume 25,000euro. Dhe kamat vonesat ne afat 15 dite ne ekzekutim te përmbauesit private.”

20. *Më 7 nëntor 2022, Komisioni për Kompensimin e Dëmit, përmes Aktvendimit [Nr.09/2049], refuzoi si të pabazuar kërkesën për kompensim dëmi të parashtruesit të kërkesës, duke theksuar se në rastin konkret nuk është përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për kompensimin e dëmit, meqenëse parashtruesi i kërkesës nuk ka mbajtur dënim, nuk ka qenë i arrestuar e as i paraburgosur, ngase vetëm këtyre personave u njihet e drejta në kompensim, “por jo edhe personave ndaj të cilëve është iniciuar proces penal dhe ka përfunduar me aktgjykim lirues, refuzues apo me aktvendim është pushuar procedura për arsye të ndryshme.*
21. *Po ashtu, Komisioni për Kompensimin e Dëmit i KGJK-së vërejti se: “në këtë rast kemi edhe parashkrim te paraqitjes së kërkesës në kuptim nenit 526 paragrafit 1 të Kodit të Procedurës Penale e cila citon ., E drejta për kompensim dëmi parashkruhet tri (3) vite pas formës se prere te aktgjykimit te shkalles se pare me te cilin i akuzuar është liruar nga akuza ose me të cilin është refuzuar akuza, apo nga forma e prerë e aktvendimit me te cilin hedhet aktakuza ose pushohet procedura. Kur për ankesë vendos gjykata më e lartë, e drejta për kompensim parashkruhet pas tri (3) vitesh nga dita e marrjes së vendimit nga gjykata e tillë.”*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. *Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit të kontestuar, atij i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 1 [Shteti], 3 [Barazia para Ligjit], 7 [Vlerat], 16 [Epërsia e Kushtetutës], 17 [Marrëveshjet Ndërkombëtare] 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22, 23, 24 [Barazia para Ligjit], 25 [E Drejta për Jetën], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 36 [E Drejta e Privatësisë], 46 [Mbrojtja e Pronës], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], dhe 112 [Parimet e Përgjithshme], 128, 132, 141, 155 të Kushtetutës, nenet 2 (E Drejta për jetën), 3 (Ndalimi i torturës), 7 (Nuk ka dënim pa ligj), 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare), 13 (E drejta për zgjidhje efektive) 14 (Ndalimi i diskriminimit), 17 (Ndalimi i shpërdorimit të të drejtave), dhe 41 (Shpërblimi i drejtë) të KEDNJ-së; dhe nenet 6, 8, 10 dhe 11 të DUDNJ-së.*
23. *Në pretendimet e tij, parashtruesi i kërkesës thekson se, gjatë procedurave, ka qenë viktimë e “dhunës psikike dhe fizike – financiare, materiale dhe pengesa nga mediat sepse, organi i akuzës, Prokuroria Themelore në Pejë, prokurori S. Gashi e ka akuzuar pa prova faktike vetëm me dyshime të pasakta jo të vërteta”.*
24. *Po ashtu, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera konstaton se ka qenë: “i lënduar shpirtërisht nga kolegët e punës, shoqëria në familje, rrethin, fisin dhe të afërmit familjarë në familje, shoqëri, punë si njeriu i pa moralshëm, i korrumpuar, i shiturë, i pa besë, person pa vlera kombëtare morale, dhe i pa ndërgjegjshëm për punën, rrethin, familje etj [...] I shkatërruar financiarisht, ndalesa në pagë, pagesa, borxhe të thella për procedura, para penale, penale, postpenale, për avokatë, ekspertiza mbledhje të provave, procedurë sa isha i akuzuar. Gjithmonë i shkatërruar nga punëtorët e sistemit të drejtësisë nga pa aftësia e tyre, akuzat e padrejta, i shpallur, i pafajshëm nga gjykata e Apelit formë të prerë, kurrë nuk janë kompenzuar nga KGJK (Kshilli gjyqësor i Kosovës). KPK (Këshilli Prokurorial i Kosovës), PK (Policia e Kosovës) etj.”*
25. *Parashtruesi i kërkesës kërkon: “kompensimin material dhe jo material dhe të postohet ne media elektronike shpallet aktgjykimi se unë jam i pa fajshëm, sepse isha objekt i*

mashttrimit dhe njollosjes se emrit dhe nderit time dhe te familjes, sime. Dëmet jo material janë te pa riparueshme dhe si dëme material janë diku 100,000 euro. Kurse, për harxhime procedurale ,pagesat e avokatit diku 20,000euro apo sipas tarifave te oak. për shkaqe të humbjes se emrit time si toger i policisë kërkoj shumën 50.000, dhe për kohën e humbur kërkoj shume 25,000euro. Dhe kamat vonesat ne afat 15 dite ne ekzekutim te përmbaruesit private.”

26. Tutje, parashtruesi i kërkesës thekson se: *“Kamë kërkuar në vitin 2020 kompenzimin për dëmet materiale, financiare nga të lartcekurit kurrë nuk më janë përgjigjur edhe pse kanë kërkuar me postë (PTK) Kërkesë për: dëmshpërblim për personat e akuzuar e të shpallur të pafajshëm. Dëmi material ishte i madh ende paguajë kredi, borxhe shokuve, miqve [...] Dëmi jo material. Asnjë herë nuk do më kompenzohet se: prishje imazhit, emrit tim në punë, shoqëri, familje etj. Deri në vdekje time nuk do të pastrohem si person që punova me nder, respekt, dashuri, sinqeritet, i drejtë për vendin tonë në: policinë e Kosovës, mbi 20 vite, shërbim i Policisë së Kosovës në gradën: Toger.*
27. Në fund, parashtruesi i kërkesës nga Gjykata kërkon: *“Kërkoj të më kompensohen: dëmi material, financiar, dëmi jo material, imazhi i emrit tim në familje, shoqëri, punë etj.”*

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- 1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*

KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE

Neni 525

(Personat të cilët kanë të drejtë kompensimi për dënim të arsyeshëm)

- 1. Të drejtë në kompensim dëmi për dënim të paarsyeshëm ka personi kundër të cilit është shqiptuar sanksioni penal në formë të prerë ose që është shpallur fajtor dhe është liruar nga dënimi por që më vonë, sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik, procedura e rishikuar është pushuar në formë të prerë ose me aktgjykim të formës së prerë është liruar nga akuza ose akuza është refuzuar, përveç në këto raste:*
 - 1.1. kur pushimi i procedurës ose aktgjykimi me të cilin akuza është refuzuar ka ndodhur për arsye se në procedurën e re i dëmtuari është tërhequr nga propozimi si rezultat i marrëveshjes me të pandehurin; ose*

1.2. kur në procedurën e rishikimit me aktvendim është hedhur poshtë akuza për shkak të moskomptencës së gjykatës, e prokurori i shtetit e ka ndërmarrë ndjekjen në gjykatën kompetente.

[...]

Neni 526
(Kërkesa për kompensim dhe parashkrimi i saj)

1. E drejta për kompensim bëmi parashkruhet tri (3) vjet pas formës së prerë të aktgjykimit të shkallës së parë me të cilin i akuzuar është liruar nga akuza ose me të cilin është refuzuar akuza, apo nga forma e prerë e aktvendimit me të cilin hedhet aktakuza ose pushohet procedura. Kur për ankesë vendos gjykata më e lartë, e drejta për kompensim parashkruhet pas tri (3) vitesh nga dita e marrjes së vendimit nga gjykata e tillë.

[...]

LIGJI Nr. 03/L-202 PËR KONFLIKTET ADMINISTRATIVE

Neni 26
Procedura në bazë të padisë

1. Konflikti administrativ fillohet me padi

2. Me padi mund të kërkohet:

2.1. anulimi ose shpallja e pavlefshme e aktit kontestues;

2.2. nxjerrja e aktit administrativ, i cili nuk është nxjerrë në afatin e parashikuar; dhe

2.3. kthimi i sendeve të marrura dhe kompensimi i dëmit i shkaktuar me ekzekutimin e aktit administrativ të kontestuar.

Neni 27

1. Padia paraqitet brenda tridhjetë (30) ditësh, që nga data e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtar palës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

28. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuar më tej me Rregullore të punës.

29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113, paragrafëve 1 dhe 7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

30. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet kritereve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individidi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

31. Përveç kësaj, Gjykata do të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur, gjithashtu kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, përkatësisht në paragrafët 1, pika (b) të rregullit 39 të Rregullores, që përcaktojnë:

*“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:
(...)*

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar”.

32. Gjykata fillimisht thekson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Vendimin [nr.09/2049] e Komisionit për Kompensimin e Dëmit të KGJK-së, të 7 nëntorit 2022, ka saktësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur, dhe ka dorëzuar kërkesën brenda afatit ligjor.
33. Megjithatë, Gjykata rikujton se rregulli për shterimin e mjeteve juridike sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 34 (1) (b) të Rregullores së punës i obligon ata që dëshirojnë të paraqesin rastin e tyre në Gjykatën Kushtetuese që së pari duhet të shfrytëzojnë mjetet juridike efektive në dispozicion në pajtim me ligjin, kundër një aktgjykimi ose vendimi të kontestuar.
34. Në këtë mënyrë, gjykatave të rregullta u jepet mundësia që të korrigjojnë gabimet e tyre gjatë procedurës së rregullt gjyqësore para se çështja të vijë në Gjykatën Kushtetuese. Ky rregull bazohet në supozimin e shprehur në nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së, që në legjislacionin vendës ka mjete juridike në dispozicion për t'u shfrytëzuar pranë gjykatave të rregullta në lidhje me shkeljet e pretenduara pavarësisht nëse dispozitat e KEDNJ-së janë inkorporuar në ligjin kombëtar apo jo (shih rastin e GJEDNJ-së, *inter alia*, [Aksoy kundër Turqisë](#), nr. 21987/93, Aktgjykim i 18 dhjetorit

1996, paragrafi 51; shih, po ashtu ndër të tjera, rastet e Gjykatës: [KI67/19](#), parashtrues *Hajrije Rina Zhitija Ajeti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 30 shtatorit 2019, paragrafi 34; [KI09/19](#), parashtrues *Leutrim Hajdari*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 marsit 2020, paragrafi 36; dhe [KI178/21](#), parashtrues *Agim Stublla*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 shkurtit 2022, paragrafi 26).

35. Parimi është se mekanizmi mbrojtës, i krijuar nga Gjykata Kushtetuese, të jetë subsidiar në raport me sistemin e rregullt gjyqësor që mbron të drejtat e njeriut (shih, rastet e Gjykatës nr. [KI15/16](#), parashtruesi i kërkesës *Ramadan Muja*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 marsit 2016, paragrafi 42; [KI178/21](#), cituar më lart, paragrafi 27).
36. Në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të ketë një rrugë të rregullt deri te mjetet juridike të cilat janë në dispozicion dhe të mjaftueshme për të siguruar një mundësi për të korrigjuar shkeljet e pretenduara. Ekzistimi i mjeteve juridike në fjalë duhet të jetë mjaft i sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, dhe nëse nuk është kështu, atëherë këtyre mjeteve juridike do t'iu mungojë disponueshmëria dhe efektiviteti i nevojshëm (shih, rastet e GJEDNJ-së, inter alia, [Vernillo kundër Francës](#), nr. 11889/85, Aktgjykim i 20 shkurtit 1991, paragrafi 27, dhe [Dalia kundër Francës](#), nr. 26102/95, Aktgjykim i 19 shkurtit 1998, paragrafi 38).
37. Gjykata duhet të shqyrtojë nëse janë shteruar mjetet juridike dhe nëse mjete juridik ishte efektiv, në dispozicion në teori dhe praktikë në kohën përkatëse, përkatësisht, që ka qenë i qasshëm, që ka mundur t'i korrigjojë shkeljet në lidhje me kundërshtimet e parashtruesit të kërkesës, dhe gjithashtu ka ofruar një perspektivë të arsyeshme për sukses (shih rastin e GJEDNJ-së, inter alia, [Civet kundër Francës](#), nr. 29340/95, Aktgjykim i 28 shtatorit 1999, paragrafët 42-44; dhe rastin e Gjykatës, [KI178/21](#), cituar më lart, paragrafi 29).
38. Megjithatë, kur një mjet juridik parashikohet me ligj, i takon parashtruesit të kërkesës të dëshmojë se mjete juridik i paraparë me ligj është shteruar me të vërtetë ose për ndonjë arsye nuk ka qenë në dispozicion dhe ka qenë joefektiv në rrethanat e posaçme të rastit, ose ka pasur rrethana të veçanta për shkak të të cilave ai ose ajo kanë qenë të liruar nga kushti i shterimit të mjeteve juridike.
39. Duke iu rikthyer rastit konkret, rezulton se parashtruesi i kërkesës pas pranimit të Vendimit [nr.09/2049] të Komisionit për Kompensimin e Dëmit të KGJK-së, të 7 nëntorit 2022, ka mundur që të iniciojë konfliktin administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Vendimit në fjalë, gjë që vërehet që nuk e ka bërë. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson faktin se të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje ligjore nga ana e Komisionit, mund të shqyrtoheshin gjatë procedurës së rregullt nga gjykatat e rregullta.
40. Prandaj, Gjykata gjen se parashtruesi e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese para shterimit të të gjitha mjeteve efektive juridike, përkatësisht se në legjislacionin e brendshëm ka mjete efektive juridike në dispozicion në gjykatat e rregullta në lidhje me shkeljen e pretenduar.
41. Andaj, lidhur me këtë, bazuar në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata thekson se nëse parashtruesit e kërkesës nuk i shterin mjetet efektive juridike të parapara me ligj, atëherë kërkesat e parashtruesve në Gjykatë konsiderohen si mos-shterje (shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës, [KI193/20](#), parashtrues *Bujar Hoti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 majit 2021, paragrafi 29).

42. Gjykata thekson se ky aktvendim për papranueshmëri nuk e pengon parashtruesin e kërkesës që në të ardhmen, sërish, të dorëzojë kërkesë kushtetuese brenda afatit ligjor 4 (katër) mujor nga dita që ka pranuar vendimin e fundit, nga gjykatat e rregullta. Ky vendim i Gjykatës konstaton që, tani për tani, kërkesa e parashtruesit është e parakohshme për arsye se legjislacioni në fuqi parasheh mjete efektive juridike përmes të cilave parashtruesi i kërkesës mund të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të tij ligjore dhe kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 34 (1) (b) të Rregullores së punës, më 14 nëntor 2023, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit;

Gjyqtarja raportuese

Selvetë Gërzhaliu Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani